


SHKRIMTARËT TANË QËNDROJNË NË ANËN E ÇËSHTJEVE ESENCIALE TË PROGRESIT

- Shpërblimi vjetor i shoqatës iu dha Rrahman Dedajt për përmbledhjen e poezive „Etje“
- U zgjodh Kryesia e re prej nëntë anëtarësh

Dje në Prishtinë u mbajt mbledhja vjetore e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, në të cilën pos shkrimtarëve dhe të ftuarve të tjerë mori pjesë edhe VAHIDE HOXHA, anëtare e KEK. Pos referatit kryesor, që e mbajti Azem Shkreli — kryetar i Shoqatës, në këtë mbledhje u paraqit edhe një raport i gjerë i punës së Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës midis dy mbledhjeve vjetore, një raport financiar dhe u bë zgjedhja e kryesisë së re.

Në raportin e punës së Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës midis dy mbledhjeve, u cekën rezultatet dhe të mbërri met më evidente të kësaj organizate në afirmimin e lëtrës në përmasa të gjera, u cekën mundësitë e shfrytëzuar bashkëpunimit ndërrepublican dhe ndërshtetëror si dhe u bë fjalë për atë se çfarë ka bërë shoqata për plotësimin e vetes prani më të thellë midis nesh. Për shkak të origjinës sociale dhe kushteve të formimit të tyre, si subjekte shoqërore e si krijuese, shkrimtarët tanë, krijues më seriozë të vlerave tona letrare, kanë afinitet dhe ndjenjë mjaft të zhvilluar t'i hetojnë ndikimet e dëmshme dhe t'u rezistojnë atyre. Ata me mjetet e tyre dhe në mënyrën e tyre të vepërimit, qëndrojnë në anën e çështjeve esenciale të progresit.



Letrarët gjithnjë e më afër shoqërisë — nga Mbledhja e djeshme vjetore e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës

min e obligimeve shoqërore që i ka ndaj anëtarëve të vet. Nga Raporti i parashtruar mund të konkludohet se vëllimi i punës së Shoqatës midis dy mbledhjeve nuk është shtuar, por është bërë përpjekje që programi i aktivitetit të kryhet sa më mirë dhe të fitojë në kualitet. Kështuqë, si në Mitingun e poezisë në Gjakovë, Takimet e Deçanit dhe disa orë letrare në Kosovë dhe jashtë saj poenta ka qënë të arrihet një cilësim kualitativ i organizimit të punës.

Duke bërë fjalë për aktualitetet të momentit letrar të ne Azem Shkreli, në referatin e tij, u ndal më së tepërmi në preokupimin e tanishëm të orientimit letrar, sidomos pas ndryshimeve të mëdha shoqërore dhe Letrës së Kryetarit, Tito, ku edhe në fushën e letërsisë kanë ndryshuar kriteret e matjes së vlerave. „Letra — tha Shkreli — ka gjetur në mesin tonë një atmosferë tjetërfare nga ca meste të tjera dhe një klimë kryesisht të shëndoshë, të paturbuluar nga rrymime e tendenca ndikimesh të huaja. Edhe në raset kur manifestuam ndonjë formë reperkutimi të tyre, tendencat dhe ndikimet e tilla kanë arritur të ne një inercion të dobësuar, të pafuqishëm të ushtrojnë ndikim më të madh në jetën tonë letrare dhe t'i sigurojnë

shtjeve esenciale të progresit.“ Sipas konstatimit të Shkreli, letrarët tanë edhe në të ardhmen duhet të jenë vigilentë dhe ta mbajnë timonin e tyre në duar të forta dhe të shëndosha. Duke bërë fjalë për momentin e tanishëm të letërsisë sonë, ai tha se poezia po ec me hapa më të shpejtë se sa proza e drama. Vargu ka mbetur akoma mjeti „më i eksploatuar“ i komunikimit tonë artistik letrar.

Në referat u bë fjalë edhe

për prezantimin e vlerave të na letrare dhe njohjen reciproke të letërsive që krijohen si në Krahinë dhe jashta saj. U tha se gjer më tani, perkundër disa rezultateve, nuk është bërë sa ka patur mundësi të bëhet në këtë drejtim dhe se kryesisht së re duhet t'i interesojë kjo çështje me të madhe.

Në mbledhje diskutuan shu më letrarë, të cilët e përkrahën kursin e përgjithshëm të orientimit letrar, por bënë vërejtje bukur të mëdha në punën e kryesisë së gjertani shme, sidomos sa u përket disa monopolizmave. Ata su-

PETRIK VAJT IA DHU- ROI SHPËRBLIMIN E VET FONDIT TË LETËRSISË

Fituesi i sivjemë i Çmimit nobël për letërsi, Petrik Vajt, vendosi që ekivalentin me të holla të këtij shpërblimi ta përdorë për themelimin e shpërblimit vjetor për shkrimtarët austrianë. Vajti deklaroi se një kompani finansiare do të marrë shumën në të holla të këtij shpërblimi prej 120 mijë dollarësh, e me të do të themelojë fondin prej të cilit do të ndahen çdo vit shpërblime për krijimtarinë letrare në Australl.

gjeruan shumë rrugë për punën e kryesisë së re, e cila do t'i eliminojë të metat që janë shfaqur deri me tash.

Në fund, pos zgjedhjes së kryesisë së re të Shoqatës prej nëntë anëtarësh, u nda edhe Shpërblimi vjetor i Shoqatës për veprën më të mirë. Sipas jurisë ky shpërblim iu dha letrarit Rrahman Dedaj për përmbledhjen e poezive „Etje“.

J. Buxhovi


VDIQ SHKRIMTARI E HUMANISTI EGJIPTIAN TAHA HUSEIN

Taha Husein, shkrimtar dhe humanist egjiptian, i cili ndonjëse ishte i vrbër, fitoi famë letrare në botë, vdiq në moshën 84 vjeçare. Vetëm një ditë para vdekjes Taha mori shpërblimin e Kombeve të Bashkuara për merita në fushën e të drejtave të njeriut, që iu dha për kontribut në lëminë e arësimit. Fjala është për një shpërblim shumë të çmuar, të dhënë për kontribute të jashtëzakonshëm në lëminë e kulturës, që janë në pajtim me aspiratat humanitare të njerëzimit dhe me qëllimet e Kombeve të Bashkuara. Një prej fituesve të këtij shpërblimi është edhe ish sekretari i Kombeve të Bashkuara U Tant.

Taha Husein, i cili ka diplomuar në Sorbonë, në Paris ka shkruar afër 70 lib

ra, shumica prej të cilave konsiderohen veprat klasike të literaturës arabe bashkëkohëse. Në Egjipt, Huseini është çmuar dhe dashur për arësye se qysh gjatë kohës së mbretit Faruk arriti të realizojë idenë e tij të arësimit të përgjithshëm dhe të obligueshëm. „Arësimi është i rëndësishëm sa ajri dhe uji“, — është një prej maksimeve të njohura të tij, të cilën regjimi i Farukut e pat pranuar por me shumë ngurim. Mirëpo, Huseini pat sukses dhe që i pari, i cili ua hap dyert shkollave dhe universiteteve të Egjiptit dhe fëmijëve të familjeve të varfëra.

Për punën e vet mori shumë dekorata prej qeverisë franceze, egjiptiane dhe të Greqisë. Për shumë vjet që kryetar i Akademisë për gjuhën arabe.



Skenë nga „Mjek me dhunë“ e Molierit të aktorëve parisienë

MOLIERI — AUTENTIK NË SKENËN TONË

- „Mjek me dhunë“ e këtij komediografi, u interpretua nga Teatri i ri nacional i Parisit, në regjinë e Jean-Louis Thamin

Teatri i ri nacional i Parisit, që sipas shënimeve që disponojmë, u formua para dy vitesh, pas një turneje nëpër Greqi, ia behu edhe në vendin tonë (ku do të qëndrojnë plot një muaj) dhe parmbamë, në Prishtinë, në skenën e Teatrit Popullor Krahinor shfaqti njërin nga pjesët e komediografisë të madh francez, Zhan Batist Molierit — „Mjek me dhunë“.

Natyrisht se vetë takimi i parë i publikut tonë me një teatër të Parisit, që më parë me fjalën e njërës ndër komediografët më të mdhenj të letërsisë botërore, Molierit, ishte tejte i mirëseardhur dhe u prit me interesim.

Molieri, që për një kohë të shkurtër shkroi 20 pjesë të ndryshme, duke filluar nga lakërdia e deri tek komedia e karakterit, në shumicën e tyre pasqyroi tablo të fuqishme të shoqërisë së kohës së tij, e veçanërisht në veprat e tij që vend problem i bashkëshortësisë e i familjes. Edhe në vendin tonë, ku po shënohet 300-vjetori i vdekjes së tij, ky komediograf është për kthyer shumë („Tartufi“, „Don Zhuan“, „Mizantropi“, „Zhorzh Dandeni“...) dhe është vënë gati në të gjitha skenat profesionaliste e amatore të kombeve e kombësive, e merret vesh, edhe në gjuhën shqipe.

Mund të themi se komedia „Mjek me dhunë“, padyshim

është njëra ndër veprat e komeditë më pak të njohura të Molierit, ku mesiguri nuk vij në në shprehje të gjitha vlerat kreative të komediografisë të madh francez.

Për shfaqjen e aktorëve parisienë, të cilët sapo e kanë kryer Konservatoriumin e la rtë nacional të teatrit ose shkollën e Strasburit, mund të bëhet fjalë si për një shfaqje të inskenuar prej njeriut që e njeh Molierin dhe fuqinë e fjalës së tij burimore e autentike, por jo edhe për farë eksperimenti që do të na ser vonte diçka, që, fjala vjen, akoma s'kemi pasur rastin të shohim në skenat e vendit tonë. Me gjasë, me një këso komedie ndoshta as është prete nduar diçka kësojore, megjithatë vetë mënyra e shtruarjes së këtij burimi, duke theksuar elementin karakteristik komik molierian, mund të jetë një kënd ndoshta edhe i ri shikimi e trajtimi, gjë që është te ndencë e parreshtur e çdo regjisori kushdo dhe kudoqoftë ai. Njëri nga shumë veset e njerëzve që i vë në thumb e tall Molieri në veprat e veta, ku mjeshtria e tij drama turgjike dhe prirja ideoke për skenën dhe komikën (ai luajti rolet kryesore në shumicën e komedive të veta në teatrin e tij) arrin që edhe spektatori të identifikohet me protagonistët e tij, — është edhe ai i nativitetit, njeriut lehtëbues e të padjallëz, që bie në gracka të nduanta, ngase nuk ia pret mendja për veprimet që i bën, — temë që trajton komedia „Mjek me dhunë“. Në pjesën e parë të kësaj komedie „ngjallohet“ Molieri përmes një aktori i cili shkruan e flet dhe prezanton protagonistët, nga disa komedi

të tij, në një hapësirë skenike të paformuar fare. Ndërkaj, në pjesën e dytë me një skenografi që e shfrytëzon për mrekulli hapësirën dhe me elasticitetin e funksionalitetin e vet u mundëson aktorëve që ta kthejnë andej-kënde sipas skenave e pamjeve të komedisë, andaj del në shesh komike molieriane e li ruar prej çfarëdo patetike, ku me elemente fare të drejtë përdrejtja skenike vihet kontakt me publikun dhe barierat gjuhësore dalngadalë thuaj se eliminohen. Sipas konceptit regjizorial të regjizorit Thamin, mizanskeni i të cilit është konstrukt mjaft preciz, është sendërtuar një shfaqje të cilën e karakterizon inventiviteti regjizorial, gjindshmëria e shkathëtsia aktorese, një shfaqje, pra, me mjaft shije dhe aromë të shfaqjes që komunikon me publikun e pothuaj çfarëdo shtrese. Të paktën kështu e shtranoi edhe publiku ynë, i cili më tepër u shprehte respekt mysafirëve të largët se sa reagoi në potezat efektive të disa aktorëve.

Pra, mbresat e para për këtë shfaqje janë se publikun tonë nuk e hutoi fare kjo shfaqje as emri i teatrit të tij me farë parangjlykimesh se ndoshta do të shikojë ndonjë „gudë teatral“ nga Parisi, megjithatë, i kushtoi rëndësinë e vëmendjen e duhur dhe e përcoill një shfaqje si shu më shfaqje të tjera të mira që janë vënë në këtë skenë.

Rolet në këtë komedi i interpretuan aktorët e rinj akademikë francezë që sapo kanë dalë nga Konservatoriumi: Jean Claude AMYL, Michel BAUMANN, Nicole CHAUSON, Yves FERRY, Alain FOUURES, Elizabeth MARGONI, Philippe MURGIER, Yves PIGONT, Anne QUENTIN, Alain ROLAND e Loic VOLARD. Dekorati dhe kostumet, të punuara nga Francoise DARNE, ndërsa muzika origjinale e Michel CHRISTODOULIDES.

Musa RAMADANI